FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 54/1	2001	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Marrëveshja e ligjit nr.8827, datë 5.11.2001	Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për transportin ndërkombëtar rrugor…….	1
Marrëveshja e ligjit nr.8828, datë 5.11.2001	Marrëveshje e Kredisë së Zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e shërbimeve bujqësore……	6

8827 945 13.11.01

MARREVESHJE

NDERMJET

QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE
DHE
QEVERISE SE REPUBLIKES SE TURQISE

PER TRANSPORTIN RRUGOR NDERKOMBETAR

Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe Qeveria e Republikes se Turqise, ketu te quajtura Pale Kontraktuese me qellim promovimin e bashkepunimit nderkombetar ne fushen e transportit rrugor, ndermjet ketyre dy vendeve dhe tranzit nepermjet territoreve te tyre, te frymezuar nga parimi i liberalizimit persa i perket transportit rrugor, te bazuar ne parimet e reciprocitetit dhe interesit te perbashket kane rene dakord si me poshte :

Neni 1

Qellimi i zbatimit

Dispozitat e kesaj Marreveshjeje zbatohen ne :

1. Transportin rrugor te udhetareve dhe mallrave ndermjet dy Paleve Kontraktuese ne tranzitin e dy territoreve respektive.

2. Udhetimin e mjeteve pa ngarkese ne lidhje me transportin e siperpermendur.

Neni 2

Perkufizime

Per qellimet e kesaj Marreveshjeje :

1. Termi "Transportues" nenkupton nje person fizik ose ligjor te vendosur ne secilen prej Paleve Kontraktuese qe ka te drejten te kryeje transportin rrugor te udhetareve ose mallrave, ne perputhje me ligjet dhe rregullat ne fuqi ne vendin e tij.

2. Termi "Mjet " nenkupton "
a. per transportin e mallrave : nje mjet te motorizuar ose nje kombinim mjetesh nga te cilat te pakten mjeti i motorizuar eshte regjistruar ne çdonjeren nga PK dhe qe eshte perdorur dhe pajisur vetem per transportin e mallrave. b. per transportin e udhetareve: çdo mjet te fuqishem te ngare, te regjistruar ne territorin e nje PK, i cili si pasoje e ndertimit ose pajisjeve te saj eshte e pershtatshme per 9 persona ulur perfshire shoferin.

3. Termi " tranzit " nenkupton transportin e mallrave dhe udhetareve nga nje transportues i regjistruar ne nje PK neper territorin e PK tjeter.

Neni 3

Transporti i udhetareve

Me qellim transportin e udhetareve:

- " Sherbimi i rregullt" nenkupton sherbimin e transportimit te udhetareve pergjate nje rruge te caktuar sipas tarifave dhe orareve te paracaktuara, ndermjet dy Paleve Kontraktuese ose ne tranzit neper territoret e tyre.

- " Sherbimi vajtje -ardhje" nenkupton nje sherbim, i cili me anen e udhetimeve te zakonshme vajtje dhe kthim kryen transportin e grupeve te udhetareve te formuara qe me pare, respektivisht nga nje vend i vetem nisjeje ne nje destinacion te vetem. Çdo grup i perbere nga udhetaret qe bene nje udhetim vajtjeje do te kthehet ne vendin e nisjes ne nje udhetim te mevonshem.

- Ne sherbimet vajtje-ardhje asnje udhetar nuk mund te merret ose te zbrtitet gjate udhetimit.
- Udhetimi i pare i kthimit dhe i fundit i nisjes ne nje seri sherbimesh vajtje-ardhje, jane bosh.

Dispozitat lidhur me operacionet e sherbimeve te rregullta dhe vajtje-ardhje do te vendosen nga Komisioni i Perbashket i cili eshte krijuar ne perputhje me nenin 11 te kesaj Marreveshjeje ne baze te marreveshjes se perbashket te autoriteteve qe nenshkruajne kete Marreveshje, te bazuar ne perfundimet e pranuara.

- Termi " Tranzit"" nenkupton transportin e udhetareve duke nisur nga territori i PK ku eshte regjistruar mjeti, duke pershkuar territorin e vendit tjeter dhe anasjelltas me kusht qe te mos merret ose zbritet asnje udhetar gjate udhetimit.

Sherbimet e rastit jane:

a. Udhetimet me dyer te mbyllura, qe quhen sherbimet ne te cilet i njejti mjet perdoret per te transportuar te njejtin grup udhetaresh gjate gjithe udhetimit dhe per ti kthyer ata perseri ne vendin e nisjes, vendin ne te cilin eshte regjistruar mjeti.

b. Sherbimet ne te cilat udhetimi i vajtjes eshte bere plot dhe udhetimi i kthimit bosh.

c. Sherbimet ne te cilat udhetimi i vajtjes eshte bere bosh dhe i kthimit i ngarkuar me udhetaret e marre ne te njejten pike te vendit ku nuk eshte regjistruar mjeti, me kusht qe udhetaret :
1. te perbejne nje grup sipas nje kontrate transporti, te perfunduar para arritjes se tyre ne territorin e PK nga ku jane marre.
2. jane te ftuar ne territorin e vendit te themelimit te transportuesit dhe kosto e transportit mbulohet nga personi qe ka bere ftesen.

Neni 4

Hyrja ne treg

1. Sherbimet e rastit te permendura ne nenin 3 do te perjashtohen nga leja e transportit per territorin e Pales Kontraktuese ku mjeti nuk eshte i regjistruar.

2. Sherbimet e rastit duhet te shoqerohen nga nje dokument kontrolli.

3. Dokumenti i kontrollit do te perfshije nje formular udhetimi.

4. Formulari i udhetimit duhet te permbaje te pakten informacionin e meposhtem:

a. tipin e sherbimit
b. itinerarin kryesor
c. transportuesit e perfshire
d. nje liste te plote te udhetareve.

5. Sherbimet e rregullta ne transportin tranzit behen me autorizimin ose lejen e leshuar nga vendi ne tranzit pasi eshte bere nje aplikim.

6. Ne transportin tranzit nuk mund te merren ose zbriten udhetare gjate udhetimit, veçse nese Komisioni i Perbashket i vendosur ne nenin 11 vendos ndryshe.

Neni 5

1. Sherbimet e rregullta dhe vajtje-ardhje jane subjekt autorizimesh (lejesh).

2. Autorizimet do te jepen nen emrin e sipermarresit transportues.
Ky i fundit nuk mund t'ia transferoje kete paleve te treta. Sidoqofte, transportuesi qe ka marre autorizimin mund ti plotesoje sherbimet e tij nepermjet nje kompanie te veçante.

3. Periudha e vlefshmerise se nje autorizimi nuk duhet te kaloje tre vjet per sherbimet e rregullta dhe 1 vit per sherbimet vajtje-ardhje.

4. Autorizimi do te specifikoje te meposhtemet :
a. tipin e sherbimit
b. rrugen e sherbimit, pikat e nisjes dhe mberritjes si dhe pikat kufitare.
c. periudhen e vleshmerise se autorizimit
d. ndalesat dhe oraret per sherbimet e rregullta.

5. Aplikimi per autorizim do te shqyrtohet nga autoritetet kompetente te Pales Kontraktuese ku eshte regjistruar mjeti. Ne rast se aplikimi pranohet, autoriteti me siper do t'ia komunikoje kete autoritetit kompetent te Pales Kontraktuese tjeter. Ne rast se ky i fundit bie dakord, atehere çdo autoritet do te jape autorizimin ne pjesen e itinerarit qe kryhet ne territorin e tij.

6. Aplikimi ne dy kopje duhet te permbaje te dhena lidhur me rregullat kombetare si dhe linjen e pershkuar stopat e autobusit te shenuara qarte, kilometrat, oraret dhe tarifat.

7. Gjate udhetimit nje kopje e autorizimit e dhene nga autoriteti zyrtar qe i leshon, ose origjinali, duhet te jene ne mjet.

8. Autorizimet duhet te behen konform modelit qe do te pergatitet nga Komisioni i Perbashket i permendur ne Nenin 11 te kesaj Marreveshjeje.

Neni 6

Ne sherbimet e rastit, mjetet qe kalojne tranzit ne territorin e nje Pale Kontraktuese dhe jane regjistruar ne Palen tjeter Kontraktuese , jane te perjashtuara nga çdo autorizim.

Neni 7

Nje sherbim i rregullt lejohet te kryhet vetem kur eshte miratuar dhe autoritetet pergjegjese te te dy Paleve Kontraktuese kane kembyer liçensat e veçanta me permbajtjen e nevojshme.

Neni 8

Transporti i mallrave :

Transportuesit e vendosur ne territorin e nje Pale Kontraktuese, lejohet te kryejne transport rrugor te mallrave ndermjet dy vendeve dhe transport tranzit ne vendet e tyre, pa qene subjekt autorizimi.
Transporti i mallrave per dhe nga vendet e treta do te jene subjekt i autorizimit.

Neni 9

Forma dhe permbajtja e lejeve te vendeve te treta te permendura ne nenin 8 percaktohen nga Komisioni i Perbashket i permendur ne nenin 11 te kesaj Marreveshjeje.
Lejet e permendura do te kembehen nga Pala Kontraktuese çdo vit nepermjet kanaleve diplomatike dhe ne perputhje me procedurat e vendosura nga Komisioni i Perbashket i permendur ne nenin 11.

Neni 10

Lejet nuk jane te nevojshme ne rastet e meposhteme:
1. transporti i objekteve nga dhe per ne aeroportet publike si pasoje e rastesise ose aksidenteve te tjera ne aeroplan ose nese aeroplani duhet te ulet ne toke per shkak te ndryshimit te kursit ose emergjencave dhe ne rast se fluturimi anulohet .
2. Transporti funeral
3. Transport i sendeve personale ne kontekstin e zhvendosjes se pajisjeve shtepiake me mjete te veçanta.
4. Transporti i postes.
5. Transporti i mallrave per panaire dhe ekspozita.
6. Transporti i aksesoreve dhe mallrave te tjera per ngjarje teatrale, muzikore etj. shfaqje cirku dhe filmi dhe paraqitja ne radio ose televizor.
7. Transporti i kafsheve te ngordhura vetem ne rast se eshte punimi industrial i lendes se pare.

8. Transporti i luleve dhe bimeve dekorative.
9. Transporti i kafsheve me perjashtim te kafsheve te therura nga mjete te pajisura per kete qellim.
10. Transporti i medikamenteve si ndihma ne rast fatkeqesish te shkaktuara nga dukuri fizike.
11. Transporti i ngarkeses per qellime edukative ose promocionale.
12. Transporti i mjeteve te demtuara ose me difekt.
13. Sipas kushteve te tjera te vendosura nga komisioni i perbashket.

Ne lidhje me operacionet e transportit te permendura ne kete nen, shoferet duhet te mbajne gjithe dokumentet qe tregojne se perfshihen ne nje nga rastet me siper.

Neni 11

Dispozita te pergjithshme

Ne menyre qe te rregullohen te gjitha çeshtjet lidhur me implementimin dhe aplikimin e kesaj Marreveshjeje, do te themelohet nje Komision i Perbashket.
Komisioni i Perbashket do te perbehet nga perfaqesuesit e Qeverive te te dy Paleve Kontraktuese qe mund te ftojne perfaqesues te industrise te transportit rrugor ne takime.
Komisioni i Perbashket do te mblidhet te pakten nje here ne vit.

Axhenda e Takimit do te paraqitet te pakten 2 jave perpara nga Palet Kontraktuese pritese ose qe e kerkon takimin.
Çdo takim do te perfundoje me miratimin e nje Protokolli te firmosur nga Kryetaret e Delegacioneve te te dy Paleve Kontraktuese.

Neni 12

Palet Kontraktuese njoftojne njeri-tjetrin qe autoritetet kompetente qe do te zgjidhin çeshtjet lidhur me implementimin e dispozitave te kesaj Marreveshjeje do te jene:

- Per Republiken e Shqiperise
  Ministria e Transportit
  Drejtoria e Transportit Rrugor
- Per Republiken e Turqise
  Ministria e Transportit
  Drejtoria e Pergjithshme e Transportit Tokesor

Neni 13

Palet Kontraktuese nuk do te marrin asnje takse si p.sh. eksport-importi ose taksa zyrtare (perfshire taksat doganore) per mjetet e regjistruara ne Palet Kontraktuese me perjashtim te :

a. taksat per perdorimin e rrjetit te infrastruktures rrugore (taksat per rruget dhe urat).
b. taksat e marra nga mirembajtja dhe mbrojtja e rruges per te paguar shpenzimet administrative te rruges dhe transportit.
c. Taksat e marra ne rast se pesha, permasat ose ngarkesa e nje mjeti kalon kufijte e percaktuara ne legjislacionin kompetar te Pales Kontraktuese.
Transporti i autorizuar ne tranzit neper territoret e Paleve Kontraktuese mund te perjashtohen nga taksat ne baze reciproke siç eshte parashikuar ne paragrafin (b) me siper.

Neni 14

Transportuesit dhe ekuipazhet e mjeteve te tyre te nje Pale Kontraktuese do te veprojne ne perputhje me ligjet dhe rregullat ne fuqi ne territorin e vendit tjeter.
Çeshtje te tjera lidhur me transportin qe nuk perfshihen ne kete Marreveshje, do te jene subjekt i ligjeve, rregullimeve dhe rregullave te Paleve Kontraktuese.

Neni 15

Siguracioni

Mjetet e Paleve Kontraktuese qe kryejne transport nderkombetar duhet te jene te siguruar si ne vendet tranzit ashtu dhe ne vendin e mberritjes.

Neni 16

Kabotazhi

Mjetet e regjistruara ne çdonjerin nga vendet e Paleve Kontraktuese nuk do te transportojne mallra ose udhetare ndermjet dy pikave brenda territorit te Pales tjeter Kontraktuese.

Neni 17

Doganat dhe Kontrolli Shendetesor

Dispozitat e Konventave Nderkombetare te miratuara nga Palet Kontraktuese zbatohen ne pikat kufitare te doganave dhe kontrollit shendetesor.
Kontrolli ne fjale behet me prioritet transportin e pacienteve, kafsheve dhe mallrave qe prishen shpejt, ne se eshte e mundur.

Neni 18

Kontrolli teknik i mjeteve

Nje mjet i nje Pale Kontraktuese qe kryen transport bilateral dhe tranzit ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese duhet te pajiset nga nje autoritet shteteror me çertifikate te vlefshme per sigurine rrugore.
Autoritetet kompetente te Paleve Kontraktuese ne territorin e te cilave kryhet operacioni i transportit mund te kerkoje kryerjen e kontrollit teknik ne mjetet e Pales tjeter Kontraktuese.
Nje mjet i njeres Pale Kontraktuese qe kryen transport bilateral ose tranzit ne territorin e Pales tjeter Kontraktuese dhe qe transporton mallra te rrezikshme duhet te kete te gjithe dokumentet e parashikuara nga Konventa ADR.

Neni 19

" Marreveshja ndermjet Qeverise se Republikes Popullore Socialiste te Shqiperise dhe Qeverise se Republikes se Turqise per transportin rrugor nderkombetar", nenshkruar ne 2 gusht 1988, do te perfundoje me hyrjen ne fuqi te kesaj Marreveshje.

Neni 20

Marreveshja do te hyje ne fuqi ne daten e kembimit te letrave qe deshmojne plotesimin e kerkesave respektive konstitucionale te Paleve Kontraktuese. Do te mbetet ne fuqi per nje vit. Pas kesaj, mund te zgjatet automatikisht per nje periudhe tjeter nje vjeçare, ne se asnje nga Palet nuk lajmeron tjetren 6 muaj perpara dates se perfundimit, per qellimin e saj per perfundimin e Marreveshjes .

Bere ne 24 SHKURT 2000 ne Tirane dy kopje origjinale ne shqip, turqisht dhe anglisht, cdo tekst eshte i barazvlershem. Ne rast diskutimi vlen versioni ne anglisht.

Ne deshmi te nenshkruarit qe jane te autorizuar per kete, kane nenshkruar kete Marreveshje.

Per Qeverine e Republikes se

Shqiperise

Astrit AVDULAJ

Drejtor Drejtorie

ne Ministrine e Transportit

Per Qeverine e Republikes se

Turqise

Ahmet BALCI

Zevendes Nensekretar

i Ministrise se Transportit

d. nr. 8828

846

13.11.01

W-1797.doc/mfs
Departamenti Juridik
DRAFT Konfidencial
(subjekti do ndryshoje)
Jfunahashi
25 Prill, 2001

DRAFTI I PUNES FILLESTARE

KREDIA NUMER 3522 AL

MARREVESHJE E KREDISE SE ZHVILLIMIT

(Projekti i Sherbimeve Bujqesore)

ndermjet

SHQIPERISE

dhe

SHOQATES PER ZHVILLIM NDERKOMBETAR (IDA)

Data 3 Korrik 2001

NUMRI I KREDISE 3522 ALB

MARREVESHJA E KREDISE SE ZHVILLIMIT

MARREVESHJA, e dates 3 Korrik, 2001, midis SHQIPERISE (Huamarresi) dhe SHOQATES PER ZHVILLIM NDERKOMBETAR (Shoqata).

MEQENESE: (A) Huamarresi, i bindur persa i perket fazes pergatitore dhe prioritetit te Projektit te pershkruar ne Kapitullin 2 te kesaj Marreveshjeje, ka kerkuar financimin e Projektit nga Shoqata:

MEQENESE Shoqata ka rene dakord ne parim, ndermjet te tjerash, per sa me siper, te shtyje afatin e Kredise se Huamarresit sipas kushteve te percaktuara ne kete Marreveshje:

KESHILLI I MINISTRAVE SEKRETARIA

QE KETEJ E TUTJE te dyja palet bien dakord si me poshte:

NENI 1

Kushtet e Pergjithshme; Perkufizime

Seksioni 1.01"Kushtet e Pergjithshme te Zbatueshme per Marreveshjet e Kredive te Zhvillimit" te Shoqates, i dates 1 Janar, 1985(plotesuar ne 6 Tetor, 1999) me modifikimet e percaktuara me poshte (Kushtet e Pergjithshme) jane pjese perberese e kesaj Marreveshjeje:

(a) Nje paragraf i ri (12) i eshte shtuar Seksionit 2.01 i shenuar me poshte, dhe paragrafet ekzistuese (12) deri ne (14) te ketij Seksioni jane shenuar perkatesisht si paragrafet (13) deri ne (15):

"12. "Vend Pjesemarres" nenkupton cdo vend per te cilin Shoqata vendos te plotesoje kerkesat e percaktuara ne Seksionin 11 te Rezolutes No. 194 te Bordit te Guvernatoreve te Shoqates, i adoptuar me 8 Prrill, 1999 dhe "Vendet Pjesemarrese" nenkupton te tilla vende bashkarisht; dhe

(b) Fjalia e dyte e Seksionit 5.01 eshte modifikuar si me poshte:

"Pervec rasteve kur Shoqata dhe Huamarresi bien dakord, nuk do te behet asnje terheqje fondesh: (a) per shpenzime ne territoret e cdo vendi qe nuk eshte vend pjesemarres ose per mallra te prokuruara ne, ose sherbime te ardhura nga territore te tilla; ose (b) per qellime pagese ndaj personave apo njesive, ose per importim mallrash, nese nje pagese apo importim i tille, sipas njohurive te Shoqates, ndalohet nga vendimi i Keshillit te Sigurise se Kombeve te Bashkuara percaktuar ne Kapitullin VII te Kartes se Kombeve te Bashkuara".

Seksioni 1.02. Nese nuk kerkohet ndryshe, disa terma te permendura ne Kushtet e Pergjithshme kane kuptimet perkatese te percaktuara aty dhe termat e meposhtme te shtuara kane kuptimet e meposhtme:

(a) "CGC" nekupton Komisionin e Granteve Konkuruese, te krijuar ne 20 prill, 2001 nepermjet Vendimit te PSC (ky percaktohet me poshte);

(b) "Shpenzimet e Pranueshme" nenkupton shpenzimet per mallrat dhe sherbimet qe i referohen Seksionit 2.02 (a) te kesaj Marreveshje

(c) "Plani i Manaxhimit te Ambientit" nenkupton planin, te pranueshem per Shoqaten, pergatitur dhe adoptuar nga Huamarresi ne perputhje me legjislacionin e Huamarresit, pershkruhet masat per mbrojtjen e ambientit, monitorimi dhe masat institucionale te Projektit.

(d) "Grant" nenkupton nje grant te aprovuar nga CGC per qellimet e Pjeses D.2 te Projektit;

(e) "Marresi i Grantit" nenkupton marresin e grantit, qe i ploteson kriteret e pargrafit 1 te Kapitullit 5 te kesaj Marreveshje

(f) "Manuali i Veprimit" nenkupton manualin, qe eshte i pranueshem nga Shoqata, te vendosura per kriteret te pranueshme per NenProjektet dhe termat dhe kushtet e Grandit sipas Pjeses D.2 te Projektit.

(g) "PMU" nenkupton Njesine e Manaxhimit te Projektit, e krijuar me Dekretin nr. 616 dt. 21 Dhjetor. 1999 ne MBU te Huamarresit, dhe ne perputhje me vendimet e paragrafit 2 te Kapitullit 4 te kesaj Marreveshje;

(h) "Raporti i Manaxhimit te Projektit" nenkupton çdo raport te pergatitur ne perputhje me Seksionin 4.02 te kesaj Marreveshje.

(i) "Paradhenie per Pregatitjen e Projektit" nenkupton qe paradhenia per pergatitjen e projektit dhene nga Shoqata Huamarresit sipas leter marreveshjes nenshkruar ne emer te Shoqates ne22 Shtator 1999 dhe ne emer te Huamerresit ne 5 Janar 2000;

(j) "PSC" nenkupton Komitetin Drejtues te Projektit, i cili perbehet nga Ministrat ose perfaqsuesit e tyre nga Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomise dhe Bashkepunimit Ekonomik, Ministria e Pushtetit Lokal, si dhe nga Shefi i Regjistrimit te Huamarresit, i cili eshte pergjegjes per rishikimin dhe aprovimin e programit vjetor te punes dhe buxhetit te PMU, vendos prioritetet, duke zgjidhur konfliktet dhe lehtesuar zbatimin e programit te punes se aprovuar.

(k) "Llogaria e Vecante" nenkupton llogarine qe i referohet Pjeses B ne Kapitullin 1 te kesaj Marreveshje

(l) "NenProjekte(t)" nekupton nenProjekte(t) e aprovuara nga CGC te financuara nga Granti per qellimet e Pjeses D.2 te Projektit; dhe

(m) "Zyra e Regjistrimit te Tiranes" nenkupton zyren e regjistrimit te pasurive te paluajteshme qe i sherben rajonit te Tiranes te Huamarresit.

NENI II

Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t'i jape hua Huamarresit. sipas termave dhe kushteve te percaktuara ose te referuara ne Marreveshjen e Kredise se Zhvillimit. nje shume ne valuta te ndryshme te barasvlefshme me shtatemilioneteteqindepesedhjetemije.

Te Drejta te Vecanta te Terheqjes (SDR7.850.000).

Seksioni 2.02. (a) Shuma e Kredise mund te terhiqet nga Llogaria e Kredise ne perputhje me vendimet e Kapitullit I te kesaj Marreveshjeje per shpenzimet e bera (ose. nese Shoqata do te bjere dakord) ne lidhje me koston e arsyeshme te mallrave dhe sherbimeve te kerkuara per Projektin dhe qe do te financohen nga Kredia.

(b) Huamarresi mund. per qellimet e Projektit. te hape dhe te mbaje ne U.S.DS nje llogari te vecante bankare sipas termave dhe kushteve te pranueshme per Shoqaten perfshire mbrojtjen nga kalimet e gabuara dhe vjedhjet. abuzimet. Depozitimet dhe pagesat nga Llogaria Speciale do te behen ne perputhje me kushtet e percaktuara ne Kapitulli I te kesaj Marreveshje.

(c) Menjehere mbas Dates te hyrjes ne fuqi . Shoqata do te terheqe. ne emer te Huamerresit. nga Llogaria e Kredise dhe do te paguaje vetvetes shumen e kerkuar per te ripaguar shumen kryesore te Paradhenies per Pergatitjen e Projektit e terhequr dhe e pashpenzuar dhe do te paguaje te gjitha borxhet papaguara deri ne kete kohe. Bilanci i shumes e autorizuar te paterhequr te Paradhenies per Pergatitjen e Projektit do te anullohet.

Seksioni 2.03. Data e Perfundimit do te jete 31 Dhjetor 2007. ose nje date e mevonshme qe percaktohet nga Shoqata. Shoqata do te njoftoje menjehere Huamarresin per kete date te mevonshme.

Seksioni 2.04. (a) Huamarresi do t'i paguaje Shoqates nje tarife mbi shumen e Kredise qe nuk mund te terhiqet here pas here ne baze te nje %, sic percaktohet nga Shoqata, me 30 Qershor te çdo viti, por qe nuk duhet te kaloje gjysmen e 1 perqindeshit per vit (1/2 e 1%).

(b) Tarifa do te rritet: (i) 60 dite pas dates se kesaj Marreveshjeje (data e rritjes) deri ne datat perkatese ne te cilat shumat do te terhiqen nga Huamarresi nga Llogaria e Kredise ose do te anullohen; dhe (ii) ne nje perqindje te vendosur ne 30 Qershor qe menjehere paraprin daten e rritjes ose te tjera ne perqindje qe mund te percaktohen here pas here ne vijim te paragrafit (a) me lart. Perqindja e vendosur ne 30 Qershor ne cdo vit do te aplikohet nga data e pageses tjeter ne ate vit te percaktuar ne Seksionin 2.06 te kesaj Marreveshje.

(c) Tarifa do te paguhet: (i) ne vendet qe Shoqata do te kete kerkesa te aresyeshme; (ii) pa asnje lloj kufizimi te imponuar nga, ose ne territorin e Huamarresit; dhe (iii) ne valuten e percaktuar ne kete Marreveshje per qellimet e Seksionit 4.02 te Kushteve te Pergjithshme ose ne nje valute ose valuta te tjera te pranueshme qe here pas here mund te percaktohen ose perzgjidhen ne vijim te vendimeve te ketij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarresi do t'i paguaje Shoqates nje tarife sherbimi sipas koeficientit tre te katertat e nje perqindeshit (3/4 e 1%) ne vit mbi shumen e Kredise se terhequr dhe te pashpenzuar here pas here.

Seksioni 2.06. Tarifat dhe tarifat e sherbimeve do te paguhen cdo gjashte muaj ne 15 Janar dhe 15 Korrik ne cdo vit.

Seksioni 2.07. (a) Lenda e paragrafeve (b), (c) dhe (d) me poshte, Huamarresi do te ripaguaje shumen e Kredise me keste gjashte - mujore te pagueshme ne cdo 15 Janar dhe 15 Korrik duke filluar ne vitin 2011, dhe duke mbaruar ne 15 Janar 2041. Cdo kest, duke perfshire dhe kestin e paguar ne 15 Janar 2021 do te jete nje perqind (1%) e kesaj shume, dhe cdo kest pas kesaj do te jete dy perqind (2%) e kesaj shume.

(b) Kur: (i) prodhimi i pergjithshem kombetar (GNP) i Huamarresit, sic percaktohet nga Shoqata, do te kete tejkaluar per tre (3) vite te njepasnjeshem nivelin e krijuar cdo vit nga Shoqata per t'i hapur rrugen burimeve te Shoqates; dhe (ii) Banka do te konsideroje vlefshmerine e kredise se Huamarresit per huadhenie nga Banka, Shoqata mund te modifikoje, menjehere pas rishikimit dhe miratimit te Drejtuesve Ekzekutive te Shoqates dhe pas marrjes ne konsiderate nga ana e tyre e zhvillimit te ekonomise se Huamarresit, ripagimin e kesteve nen paragrafin (a) me lart duke:

(A) i kerkuar Huamarresit te ripaguaje dyfishin e shumes se çdo kesti akoma te papaguar deri sa te ripaguhet shuma e Kredise: dhe

(B) i kerkuar Huamarresit te filloje ripagimin e shumes se Kredise persa i perket dates se pageses se pare gjashte-mujore se ciles i referohet paragrafi (a)me lart pas gjashte (6) muajve ose me teper pas dates ne te cilen Shoqata. njofton Huamarresin se jane realizuar situata: e permendura ne paragrafin (b). por. megjithate. do te lihet nje periudhe minimumi prej pese (5) vjetesh per kete ripagim

(c) Nese kerkohet nga Huamarresi. Shoqata mund te rishqyrtoje modifikimet e referuara ne paragrafin (b) me lart. per te perfshire. te gjitha rritjet ne shumat e ketyre kesteve. pagesa e interesit ne nje interes vjetor per te cilin ka rene dakord Shoqata mbi shumen e Kredise se terhequr dhe te pashpenzuar here pas here. ne menyre qe. sipas gjykimit te Shoqates. rishqyrtimi nuk do te ndryshoje elementin e perfituar te Grantit nga modifikimi i ripageses se mesiperme.

(d) Nese. pas modifikimit te termave ne vijim te paragrafit (b) me lart. Shoqata ve re se situata ekonomike e Huamarresit ka rene ne menyre te ndjeshme. Shoqata. nese kerkohet nga Huamarresi, mund te modifikoje me tej termat e ripagimit per te qene ne konformitet me grafikun e kesteve te percaktuara ne paragrafin (a) me lart.

Seksioni 2.08. Valuta e Shteteve te Bashkuara te Amerikes specifikohet per qellime te Seksionit 4.02 te Kushteve te Pergjithshme.

NENI III

Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01. (a) Huamarresi deklaron perkushtimin ndaj objektivave te Projektit te percaktuara ne Kapitullin 2 te kesaj Marreveshje, se do te zbatoje Projektin nepermjet PMU-se me eficience te plote dhe ne konformitet me praktikat e duhura administrative, financiare do te siguroje, sapo te jete nevoja, fondet, pajisjet, sherbimet dhe te tjera burime te kerkuara per Projektin; dhe

(b) Pa kufizuar vendimet e paragrafit (a) te ketij Seksioni dhe ne rast se Huamarresi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, Huamarresi do te (i) zbatoje Projektin ne perputhje me Programin e Zbatimit te Percaktuar ne Kapitullin 4 te kesaj Marreveshje; dhe (ii) do te zbatoje Pjesen D.2 te Projektit ne perputhje me Manualin e Veprimit dhe termat dhe kushtet te percaktuara ne Kapitullin 5 te kesaj Marreveshje.

Seksioni 3.02. Ne rast se Shoqata do te bjere dakord, prokurimi i mallrave, punimeve dhe sherbimeve te konsulenteve qe kerkohen per Projektin dhe qe do te financohen nga fondet e Kredise do te behet sipas vendimeve te Kapitullit 3 te kesaj Marreveshjeje.

Seksioni 3.03. Per qellime te Seksionit 9.06 te Kushteve te Pergjithshme dhe pa kufizime, Huamarresi do te:

(a) do te pergatise ne baze te udhezimeve te pranueshme per Shoqaten, dhe do t'i dergoje Shoqates jo me vone se gjashte (6) muaj pas Dates se Perfundimit ose ne nje date te mevonshme sic mund te bihet dakord per kete qellim midis Huamarresit dhe Shoqates, nje plan per ecurine e Projektit ne te ardhmen; dhe

(b) do t'i siguroje Shoqates mundesi te arsyeshme per te shkembyer pikepamje me Huamarresin mbi planin e mesiperm.

NENI IV

Pakti Financiar

Seksioni 4.01 (a) Huamarresi do te mirembaje nje sistem manaxhimi financiar, duke perfshire arshivimet dhe llogarite, dhe te pergatise gjendjet financiare ne perputhje me standartet e pranueshme per Shoqaten, te pershtatshme per te reflektuar veprimet, burimet dhe shpenzimet qe lidhen me Projektin.

(b) Huamarresi do te:

(i) per te pasur rregjistrimet, llogarite dhe pasqyrat financiare te referuara ne paragrafin (a) te ketij Seksioni duke perfshire regjistrimet dhe llogarite per Llogarine e Vecante per cdo vit fiskal te audituar, ne perputhje me standartet audituese te pranueshme per Shoqaten, qe vazhdojne te zbatohen, nga auditues te pavarur te pranueshem per Shoqaten;

(ii) per t'i dorezuar Shoqates sa me shpejt te jete e mundur, por ne cdo rast jo me vone se gjashte (6) muaj pas cdo fund viti (A)kopjen e pasqyres financiare, qe i referohet paragrafit (a) te ketij viti te audituar, dhe (B) nje opinion per pasqyrat financiare, regjistrimet dhe llogarite, raportin e auditit, qellimin dhe disa hollesira te cilat jane kerkuar nga Shoqata; dhe

(iii) per te informuar Shoqaten ne lidhje me regjistrimet. llogarite dhe auditimin sic do te kerkoje Shoqata here pas here.

(c) Per te gjitha shpenzimet ne lidhje me te cilat jane bere terheqje fondesh nga Llogaria e Kredise ne baze te pasqyres se shpenzimeve. Huamarresi:

(i) do te mirembaje. ne perputhje me paragrafin (a) te ketij Seksioni. regjistrimet dhe llogarite qe reflektojne keto shpenzime:

(ii) do te ruaje. deri te pakten nje vit pasi Shoqata te kete marre raportin e auditimit per vitin fiskal ne te cilin u be terheqja e fundit e fondeve nga Llogaria e Kredise. te gjitha regjistrimet (kontratat. urdherat. faturat. pagesat dhe dokumenta te tjere) qe pasqyrojne keto shpenzime:

(iii) do te ndihmoje perfaqesuesit e Shoqates per te analizuar keto regjistrime: dhe

(iv) do te siguroje se te regjistrimet dhe llogarite jane perfshire ne auditimin vjetor duke ju referuar paragrafit (b) te ketij Seksioni dhe se raporti i auditimit

permban nje opinion te vecante te audituesve persa i perket faktit nese pasqyra e shpenzimeve te paraqitura gjate vitit fiskal bashke me procedurat dhe kontrollet e brendshme te perfshira ne pergatitjen e tyre, mund te besohen per te justifikuar terheqjen e fondeve qe lidhen me to.

Seksioni 4.02. (a) pa kufizimet e vendimeve ne Seksioni. 4.01 te kesaj Marreveshje. Huamarresi do te kryeje nje plan veprimi ne kohe te miratuar nga Shoqata per fuqizimin e sistemit manaxhimit financiar qe i referohet paragrafit (a) te Seksionit 4.01 per Huamarresin, jo me vone se 30 Qershor, 2002, ose jo me vone se data e miratimit nga Shoqata, te pergatise Raportet tremujore te Manaxhimit te Projektit, te pranueshem nga Shoqata, per:

i) (A)te percaktoje burimet aktuale dhe aplikimet e fondeve per projektin, kumulative dhe per periudhen per te cilen raportohet, dhe burimet e projektit dhe aplikimet e fondeve per periudhen 6 mujore mbas periudhes te raportit te meparshem, dhe (B) te tregoje ndarjen e fondeve te financuara gjate Kredise dhe periudhes per te cilen raportohet dhe shpenzimet e propozuara per tu financuar gjate Kredise dhe gjate gjashtemujorit qe ndjeke periudhen qe raportohet:

ii) (A) pershkruan progresin fizik te Zbatimit te Projektit, si per periudhen e meparshme dhe per periudhen qe

raportohet. dhe (B) shpjegon ndryshimet midis objektivave te parashikuara me ato aktuale: dhe

iii) vendosja e statusit te prokurimit te Projektit dhe shpenzimet ne kontratat e financuara nga Kredia. si dhe ne fund te periudhes qe raportohet.

(b) Per kompletimin e planit te veprimit qe i referohet paragrafit (a) ketij Seksioni. Huamarresi do te pergatise. ne perputhje me udhezimet e aprovuara nga Shoqata. dhe tia paraqese Shoqates jo me vone se 45 dite nbas mbarimit te Raportit tremujor te Manaxhimit te Projektit per kete periudhe.

NENI V

Demshperblimet e Shoqates

Seksioni 5.01. Sipas Seksionit 6.02 (1) te Kushteve te Pergjithshme, çeshtjet shtese te meposhteme specifikohen:

(a) Manuali i Veprimit duhet te permisohe,pezullohet, shfuqizohet, anullohet ose shtyhet, ose vendimet ligjore duhet te miratohen, qe ndikon ne opinionin e Shoqates per te realizuar Projektin.

(b) Ligji Nr. 8732 i dates 24 Janar 2001 ka permisuar, pezulluar, shfuqizuar, anülluar ose shtyre te cilat ndikojne ne opinionin e Shoqates per realizimin e Projektit.

Seksioni 5.02. Sipas Seksionit 7.01 (h) te Kushteve te Pergjithshme specifikohet çeshtje shtese te mevonshme, kryesisht, nese ngjarjet e specifikuara Seksioni 6.01 (a) dhe (b) te kesaj Marreveshje do te ndodhin.

NENI VI

Perfundimi

Seksioni 6.01. Nentedhjete dite (90) dite pas dates se kesaj Marreveshje te specifikuar per qellimet te Seksionit 12.04 te Kushteve te Pergjithshme

NENI VII

Perfaqsuesi i Huamarresit: Adresat

Seksioni 7.01 Ministria e Financave e Huamarresit eshte percaktuar si perfaqsuese e Huamarresit per qellimet e Seksionit 11.03 te Kushteve te Pergjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e meposhtme jane specifikuar per qellimet e Seksionit 11.01 te Kushteve te Pergjithshme:

Per Huamarresin:

Ministria e Financave

Bulevardi "Deshmoret e Kombit"

Tirana

Shqiperia

Fax:

355 42 28494

Per Shoqaten

International Development Association

1818 H Street, N.W

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa elektronike:	Teleks:	Fax:
INDEVAS	248423(MCI) ose	(202) 477-6391
Washington, D.C.	64145(MCI)	

DESHMITARET e te dyja paleve, duke vepruar si perfaqesues te autorizuar, nenshkruan kete Marreveshje ne emer te tyre ne Shtetin e Kolumbise, Shtetet e Bashkuara te Amerikes, ne diten dhe vitin e shenuar me siper.

SHQIPERIA

Nga FATOS TARIFA
AMBASADOR

Perfaqesues i Autorizuar

SHOQATA E ZHVILLIMIT NDERKOMBETAR

Nga CHRISTIAN POORTHAN

Zevendes President i Rajonit te
Evropes dhe Azise Qendrore

KAPITULLI 1

Terheqja e Fondeve te Kredise

A. Te pergjithshme

